



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT-OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-lizazne

Nr. 156
Br.

Data 10.04.2019
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI¹⁸, mbledhja e 4) me dt.18.04.2019 (e enjte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës
4. Formimi i Komisioneve, sipas vendimit të Qeverisë nr.07/96, të dt.02.4.2019 (Plotësimi dhe Ndryshimi i Komisioneve
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Datës-izdaje

Nr. 1-57
Df.

Data 10.04.2019
Datum

TRITIO-OBILIC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.3.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Qëndresa Dubova, Florije Jashari, Shaip Paloja, Fatmir Bekteshi, Arbnore Nasufi, Lulzim Sadiku, Hysni Mjeku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, Naim Miftari, UD-së drejtorit të Ad. së përgjithshme, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH-së, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Burim Ismaili, drejtor i DI-së, Fatmir Bërbatovci, drejtor i DKRS-së, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, përf. e OSBE-së, përf.e KFOR-it dhe përf.i KDI-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës, nismën për bashkëpunim ndër komunal/at (Komunës së Prishtinës, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Vushtrrisë) në fushën e infrastrukturës fizike
4. Shqyrtimi i planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore
6. Shqyrtimi i raporteve përfundimtare të Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunal në shfrytëzim :
 - a) Raporti me nr V-188 , datë:22.02.2019
 - b) Raporti me nr V-187 , date :22.02.2019
7. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së
8. Shqyrtimi i kërkesës së MAPL-së (rishikimi i vendimit nr. 203 dt.28.12.2018)
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

Burim Gërguri – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Mungoi: Nazmi Gashi, Fatos Kurshumlija, Linda Sadiku dhe Armend Rushiti me leje, ndërsa Agon Mjekiqi pa leje.

Pika e 2 e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika 3 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet Propozimin e Kryetarit të Komunës, nismën për bashkëpunim ndërkomunal (Komunës së Prishtinës, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Vushtrrisë) në fushën e infrastrukturës fizike.

Kryetari – Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me Komunën e Prishtinës, Podujevës dhe Vushtrrisë në fushën e infrastrukturës fizike duke ofruar dhe pranuar shërbime qytetarëve në fushën e sigurisë publike. Bashkëpunimi do të bazohet mbi bazat e njejta reciprociteti dhe përfitimit të shumëanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik. Me anë të këtij bashkëpunimi ne synojmë që aksi rrugor Stanovc i Epërm-Breznicë-Kozaricë-Barilevë-Lupç i Poshtëm, të investohet në trotuar, ndriçim publik dhe asfaltim. Po ashtu, bazuar edhe në thirrjen për aplikime për financime të projekteve për bashkëpunim ndërkomunal të lansuar nga MAPL-ja, për vitin 2019.

Shaip Paloja – Pyeti nëse, Komunitat tjera nuk i përmbahen memorandumit a do të realizohen projektet tona.

Kryetari – Përgjegjet shpresoj se do të kaloj si projekt, por nëse nuk kalon si projekt ne MAPL për bashkëfinancim për pjesën tonë të territorit do të fillojmë këtë vit.

Xhezide Dragusha – Pyeti se gjatë këtij bashkëpunimi cilat janë përfitimet e Komunës tonë.

Kryetari – Përgjegjet se përfitimi është aq sa mund të nxjerrim nga Ministria, nga ai fond që është 1 milion dhe të drejtën e aplikimit e kanë të gjitha Komunitat që planifikojnë bashkëfinancim, por meqenëse ne jemi 4 Komuna besoj se do të merret parasysh për dallim nga Komunitat tjera. Arsyeshmëria është rruga e dëmtuar, trotuari dhe ndriçimi nuk ekziston, por ne po bëjmë përpjekje për me mund me i realizue. Në të kundërtën ne e kemi planifikue edhe ndriçimin me zhvillue në atë zonë, fazën e parë të trotuarit dhe renovimin e rrugës që është e dëmtuar.

Fatmir Bektashi – Pyeti nëse, nuk impementohet kjo marrëveshje memorandumit kur mendon me mjetet vetanake me fillue diametrin rrugor Breznicë-Kozaricë.

Kryetari – Përgjegjet se deri me 11 prill përmbillet aplikimi dhe atëherë ne mund ta dijmë saktë se a jemi përfitues apo jo, e nëse jo ne e kemi të përgatitur paramasën dhe paralograrinë dhe shpresoj se pas datës 11 menjëherë ta shpallim.

Burim Gërguri – Realisht, është iniciativa më e madhe që ka ndodhur ndonjëherë në mes të Komunave sepse po lidhet me kryeqytetin dhe Komunitat përreth dhe shpresoj se do të kemi mirëpuktim për shkak të përgjegjësisë së marrë si Kryetar, si Komunitat lidere me trajtue dhe pse jo me pasë qasje në atë fond. Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet Propozimi i Kryetarit të Komunës, nismën për bashkëpunim ndërkomunal (Komunës së Prishtinës, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Vushtrrisë) në fushën e infrastrukturës fizike.

Pika e 4 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet planin e punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2019. Ne në mbledhjen e KPF-së, e kemi shqyrtuar këtë plan dhe Kryetari për shkak të transparencës së plotë na e ka ofruar planin e punës për vitin 2019, i cili nuk votohet, por vetëm shqyrtohet.

Kryetari – Ju e keni parë se është një plan bukur i ngjeshur sa i përket aktiviteteve dhe unë do të bëjë përpjekje maksimale që të realizohet. Ne kemi edhe projekte tjera, që në ndërkohë kemi aplikue dhe që do të jenë pjesë e këtij plani të punës. Mirëpo, besoj se do të implementohet me përpikëri dhe nëse, ka ndonjë plotësim apo ndryshim mund ta diskutojmë.

Pika e 5 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Ju e dini se Draft Rregulloren për ndarjen e bursave e kemi dhënë në debat publik dhe

këtë Draft Rregullore, e kemi debatuar edhe në mbledhjen e KPF-së.

Agim Spahiu – Në Draft Rregulloren për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore i paraqiti këto plotësime dhe ndryshime:

-Në Draft Rregulloren e re janë prezente 2 komponente, komponenta e ndihmës humane dhe e shpërblimeve.

- Bursa do të fitojnë të gjithë studentët e regjistruar të rregulltë të bartësve publik të Arsimit të lartë duke filluar nga viti i dytë i studimeve. Përfundimisht bëjnë 2 kategori që do të përfitojnë bursa edhe për vitin e parë të studimeve, janë studentët me nevoja të veçanta apo aftësi të kufizuara dhe fëmijët e dëshmorëve.

- Është risi se është menduar të shpërblehet suksesi i studentit, do të merrë bursë edhe studenti i cili e ka skajshmërisht notën më të ulët 6.00, edhe studenti i të njëjtit vit edhe studenti 10.00. Kategoria e bursës prej 6-8, do të jetë një kategori e caktuar, ndërsa 8 e më tepër do të jetë një kategori tjetër, që lartësinë e bursës të këtyre kategorive është paraparë ta cakton Kryetari.

-Te nxënësat e 2 shkollave të mesme, është mendue t'ju ndahet bursa të gjithë nxënësve ashtu si ka qenë edhe më parë të shkollës teknike "Ismail Dumoshi" që nga viti i 10. Ndërsa, bursat do të ndahen edhe për gjimnazin që nga viti i dytë, por edhe në këtë nivel të shkollimit do të ndahet bursë për rastet sociale në aspektin ekonomiko-financiar nëse, suksesi i tyre është së paku i mirë që nga klasa e 10.

- Është mendue që për të gjithë nxënësat e SHM dhe SHF, nëse distanca shkollë-shtëpi është më e gjatë se 3.5 km, mbulimin e shpenzimeve ta merrë Komuna. Po ashtu, edhe për të gjithë nxënësit për rastet sociale, mbulimin e shpenzimeve do ta merrë Komuna dhe kategori tjetër janë nxënësat me aftësi të kufizuara.

-Ne e kemi futë si kategori e përfituesve për raste sociale edhe kompenzimin e aktiviteteve jashtëshkollore që nënkupton mbulimin e shpenzimeve të rastet sociale të ekskurzionit dhe mbrëmjes së maturës për maturanët, shetitjen dhe semi maturën për nxënësit e klasëve të 9.

-Në Rregullore është paraparë sikurse edhe në Rregulloren e mëparshme edhe ndarja e çmimit "Adem Preniqi" prej fondit të Kryetarit, por është një plotësim se garën për studentin më të mirë për çmimin "Adem Preniqi" do ta fitojnë studentët të cilët do të kenë të drejtë të garojnë në vitin e fundit të studimeve.

Shaip Paloja – Paraqiti këto propozime:

-Te neni 2, te shuma e mjeteve, duhet të përcaktohet viti paraprak që të dihet saktë dhe në vitin që pason nëse, ka mjete më tepër të rritet numri i studentëve që do të përfitojnë ose nxënësve për udhëtim.

-Te neni 3, Kryetari duhet ta cakton shumën e mjeteve, por duhet të kaloj përmes Kuvendit komunal dhe Kuvendi komunal të nxjerrë vendim për këtë çështje.

-Te neni 5, dy Komisionet duhet ti caktoj Kuvendi komunal ose mundësisht në bashkëveprim me Kryetarin, të votohen në Kuvend me mundësi që Komisioni të jetë sa më profesional.

-Te kategorizimi unë nuk kam mund ta kuptoj se a është shuma e mjeteve në bazë të kategorizimit që do të përfitojnë studentët, ku secila kategori do të jetë më tepër përfituese.

-Te neni 10, te studentët me aftësi të kufizuara dhe studentët e dëshmorëve, mendoj se për këto 2 kategori nuk duhet të ketë kufizime kur kemi parasysh se studentët me aftësi të kufizuara dhe nxënësit fatkqesësisht te ne nuk ka shkolla speciale sepse ata duhet të trajtohen në shkolla speciale. Te studentët e dëshmorëve nuk duhet të ketë fare kufizime, por duhet të jetë kriteri që të jenë të rregulltë në shkollë dhe mos të kenë mungesa.

-Te neni 11, ku thuhet se Komisioni për ndarjen e bursave, duhet të ketë qasje në verifikimin e dokumentacionit, mendoj se përveç Komisionit për ndarje duhet të ketë qasje edhe Komisioni i ankesave, për dokumentacionin e atyre, që kanë fituar se a është në rregullë.

-Te neni 15, nxënësit me raste sociale me rezultat të mirë, propozoj të shtohet edhe numri i mungesave në shkollë së paku të jenë të rregulltë, ose të jetë një numër i caktuar i mungesave që ai nuk mund ti tejkaloj.

-Te neni 21, propozoj të jetë së paku 10 ditë e drejta e ankesës, pas shpalljes së emrave të përfituesve.

-Te neni 23, propozoj që mjetet mundësisht t'ju shkojnë në formë mujore Agjensioneve që i bartin nxënësit ose është mirë të gjendet një formë që nxënësve mos t'ju barten mjetet në xhirollogari sepse e kanë moshën adoleshente dhe ato mjete mund të shkojnë në ndonjë destinim tjetër.

Aziz Bici – Kjo Rregullore lenë hapësirë për të kuptuar në forma të ndryshme, fjala është për neni 2, ku thuhet se bursat ndahen sipas mundësisë financiare që ka Komuna në dispozicion. Kjo për neve, është e paqartë sepse duhet të ceket për secilin vit mundësia e alokimit të mjeteve për bursa. Te neni 10, mbështetja e kategorive të ndryshme sidomos pika 1.5, ku ceket se përfitues do të jenë edhe studentët minoritar dhe pyes se a do të mbështeten vetëm studentët minoritar të cilët studjojnë në shkollat e fakultetet e Republikës së Kosovës, apo edhe ata që shkollohen e studjojnë në shkolla e fakultete paralele në Kosovë. Po ashtu, ne jemi kundër ekskursioneve dhe udhëtimeve që nuk planifikohen me qëllim të edukimit të përgjithshëm të këtyre nxënësve, përkatësisht njohjen e tyre me kulturën e traditat e qyteteve ku ata i vizitojnë. Pyetja tjetër është se a e dini sa është numri i studentëve dhe nxënësve në Komunën tonë dhe sa do të jetë lartësia e bursës. Duke parë se kjo Rregullore lenë hapësirë të kuptohet në disa forma ne si LVV nuk do ta mbështesim.

Hysni Mjeku – Ne në mbledhjen e KPF-së, e kemi analizuar Rregulloren dhe krahasuar nga Rregulloret e më parshme dukshëm është e avansuar si në pikëpamje procedurale ashtu edhe në pikëpamje të ndarsjes së bursave për të gjitha kategoritë, që vërtetë e meritojnë. Te afatet kam një vërejtje sepse afatet janë të përcaktuara me ligj prej 7, 15 ose 30 ditë, dhe besoj se më tepër kjo është anë teknike, që nuk e dëmton rëndësinë e Rregullores. Sa i përket numrit të nxënësve, numrit të studentëve të cilët do të jenë përfitues krahasuar me periudhat e kaluara është rritë për 70 % dhe jo rastësisht sot sikur koincidojmë me thënjen e të madhit Sami Frashëri: "Nëse, do të mbjellësh për një vit mbjellë misër e grurë, nëse kërkon që të mbjellësh përgjithmonë mbjellë në Arsim dhe Kulturë". Pajtoj me thënien e përfaqësuesit të LVV-së, sepse duhet të përfitojnë vetëm ata banorë që e njohin dhe punojnë për Republikën e Kosovës, në të kundërtën nuk guxon të keqpërdoret paraja publike. Unë besoj se edhe komunitetet tjera, duhet ta kuptojnë njëherë e përgjithmonë se paraja është e jona, ne jemi menaxherë dhe duhet të destinohet aty ku duhet. Ne edhe në përkrahje të komuniteteve jemi në përparësi me Komunitat tjera, prandaj këtu duhet të respektohet Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Burim Gërguri – Unë dua t'ua heqë dilemën se është neni 10, pika 1,5, fjala është për institucionet e Republikës së Kosovës dhe në asnjë formë tjetër, ky Kuvend voton dhe aprovon vetëm dokumente valide bazuar në Kushtetutën, ligjet dhe LVL-në.

Xhezide Dragusha – Unë kam një pyetje te fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçanta, unë e di se janë të ndryshme dhe a kemi statistika në Komunën tonë se sa janë. Siç e dijmë ne personat me aftësi të kufizuara nuk mund ta vijnë shkollën, por duhet të kenë një edukim në shkolla speciale dhe me pasë një arsye se a është i gatshëm ai me vazhdu shkollën.

Agim Spahiu – Përgjegjet se është neni 2, Komuna e Obiliqit varësisht prej mjeteve financiare që i ka në dispozicion ndan bursa për nxënës dhe studentë të Komunës së Obiliqit, që mësimet përkatësisht studimet i vijnë në bartësit publik të Arsimit parauniversitar dhe universitar, kuptohet në shkolla publike. Shuma financiare e subvencioneve të këtyre kategorive është 126,000 €. Këto, janë subvencione të Kryetarit dhe Kryetari i formon Komisionet, është Komisioni për ndarjen e bursave dhe Komisioni i ankesave. Te kategoritë, janë 5 kategori dhe brenda të njëjtit vit të studimeve do të marrë bursë edhe studenti me 6.00 dhe 10.00, por ky me 10,00 ose me 8 e më tepër të notës mesatare, do të jetë një kategori më e lartë. Ndryshimin nga kategoria e parë në kategorinë e dytë, do ta përcakton nevoja e mjeteve në disponim që i kemi sepse sipas kësaj Rregulloreje nuk është i definuar numri absolut i bursave. Mirëpo, të gjithë studentët nga viti i dytë përfitojnë, orientimisht sipas statistikave që disponojmë ky numër duhet të jetë afërsisht 100. Përjashtim prej këtyre kategorive bëjnë fëmijët e dëshmorëve dhe personat me aftësi të kufizuara që marrin bursë edhe për vitin e parë të studimeve. Neni 10, paragrafi 2.1 dhe 2.2, këto 2 kategori kanë bonus, plus një pikë të vlerës të notës mesatare, që do të thotë nëse, studenti fëmijë i dëshmorëve e ka notën mesatare 7, do të ishte në kategorinë e parë të bursave dhe me këtë bonus atij i numrohet edhe një pikë, e ka kategorinë 8 dhe e kalon kategorinë e dytë të bursës, do të thotë merrë bursë më të lartë. Nuk kuptohet, nuk ka dualizëm, as nuk interpretohet që ndahet bursë për komunitetin pakicë në shkolla apo në nivelin akademik, që nuk janë në sistemin e Ministrisë së Arsimit. Mirëpo, është menduar se ne kemi

pakicë edhe të komuniteteve tjera RAE, turq dhe nëse ata janë aplikues të bursës, i plotësojnë kriteret, janë banorë të Obiliqit, të kenë bonus 0.5 të notës mesatare për kategorinë e bursës. Dëshmi për raste sociale, nuk është kuptuar, por nëse ka dilema e plotësojmë nenin 11, por është menduar Komisioni për trajtimin e procedurave për ndarjen e bursave e ruan të drejtën të hulumtoj dhe vërtetoj gjendjen e vërtetë ekonomike dhe financiare të kandidatit. Tani i përgjegjem z.Hysni Mjeku, se nuk është rritë për 70 %, por 400 %, mundësia e bursës. Te neni 15, paragrafi 1.4, e përjashton mundësinë që nxënësi të marrë bursë dhe të mos vijon mësimin, por e kushtëzon të jetë nxënës i rregulltë dhe të vijon mësimin rregullisht në SHM të Komunës së Obiliqit. Te neni 21, kishte dilema për afatin për ankesa, që në Draft Rregullore e kemi pasur 15 ditë, por pas diskutimit publik dhe shqyrtimin me auditorin u tha se është afat i gjatë, që s'ka nevojë dhe nuk kemi shumë komoditet që t'ju japim afatin 15 ditë. Prandaj duhet të praktikohet e drejta e ankesës 5 ditë. Sa i përket mjeteve, që mos të shkojnë në xhirollogari të fëmiut, ne kemi raste kur fëmiu në SHF dhe SHM, nuk e ka të hapur xhirollogarinë dhe ne kemi mendue që mjetet të kenë mundësi të alokohen në llogari të prindërve dhe në disa raste edhe të kujdestarëve të tyre. Unë e kam edhe një koment për z.Aziz Bici, ju mund ti jepni propozimet, këshillat që kjo Rregullore të mos kuptohet në disa forma, por krejtë qëllimi është të delë sa më e precizuar, të përfitojnë nxënësit, ta kuptojnë drejtë dhe të mos ketë dilema në interpretim.

Kryetari – Drejtori e tha se Komisionet i cakton Kryetari, por edhe pse është e drejta ime e caktimit, nuk prishë punë fare sepse ne mund ti bëjmë 2 Komisionet mikes, me anëtarë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

Aziz Bici – Mua, më vjen keq që nuk kam qenë këtu, kur ka fillue drejtori prezentimin e Draft Rregullores por kuptova që tha se do të ndahet bursë edhe për ata nxënës të cilët së paku e kanë suksesin e mirë. Mendoj se duhet të ketë njëfarë kriteri, fjala është edhe për studentë sepse nëse, ne dojmë ti bëjmë fëmijët tonë krejtë me fakultete, atëherë, kjo nuk është në interesin tonë të Komunës, që të arrijmë të ndajmë sa më shumë mjete. Për këtë arsye po them se këtu, lenë mundësinë edhe ndarja e mjeteve që nuk po bëhet paraprakisht që me pasë ne një informacion me ditë që në vitin në vijim sa studenta, për çfarë profesione dhe me çfarë sukses janë ata. Edhe ne i përkrahim sidomos për kategoritë që u folën këtu, fëmijët e dëshmorëve dhe personat me nevoja të veçanta, por të mbetet kështu në përgjithësi çështja e mjeteve ashtu siç janë mjetet do të bëhet edhe ndarja, kjo lenë mundësi dyshimi.

Fatmir Bekteshi – Mendoj se kur është çështja e pagesave të nxënësve, unë nuk them që mjetet ti bartni në xhirollogari të prindit ose nxënësit sepse këtu po flitet më shumë për transport dhe gjatë shkuarjes në ekskurzion. Mendoj se këtë e arsyeton vetëm kompania duke e sjellë fakturën dhe lirohet nxënësi.

Kryetari – Sqaron se janë arsyet ligjore që është përzgjedhë të bëhet pagesa në këtë formë. Mirëpo, nuk nënkupton për të gjithë se do të ndodhë në të gjitha vijat sepse ka raste kur ne nuk kemi transport të organizuar dhe ka mundësi fshati, ose lagjja me organizue dhe kjo është një prej mundësive. Aty, ku ka transport të organizuar besoj se do të bëhen kontraktime me kompaninë përmes mujoreve dhe ne do ti blejmë mujoret. Ju informoj se ne jemi shumë të interesuar që ta formojmë një ekip i cili do të merret me studim të fizibilitetit sa i përket çështjes së transportit me pa mundësinë se sa do të ishte kostoja për neve nëse, ne kemi me i ble të gjitha vijat e transportit me të vetmin qëllim që transporti të jetë i rregulltë.

Agim Spahiu – Po, z.Aziz nuk ishte gjatë fillimit dhe për atë ka dilema. E theksova në fillim se jemi kujdesur që Rregullorja ti ketë 2 komponente, komponentën e ndihmës dhe të shpërblimit. Pikërisht pyetjen që e bëre pse nxënësve të mirë me ju nda bursa, është pika 1.3, te neni 15, për nxënës familjet e të cilëve janë raste sociale. Do të thotë është kategori, në aspektin e gjendjes ekonomiko-financiare të kenë të përfunduar klasën paraprake, së paku me sukses të mirë. Këtu, fjala është vetëm për nxënës me saste sociale. Ndërsa komponenta e shpërblimit është që nxënësi të jetë i shkëlqyeshëm. Në vitin 2017, ne 3 herë kemi udhëheqë procedura tenderimi për me përfitue një kompani për bartjen e nxënësve dhe nuk kemi arritë me realizue sepse kanë dështue tenderët për shkak të operatorëve që nuk i kishin kushtet teknike të specifikuara sipas kërkesave së tenderëve. Për me ju ndihmue këtyre kategorive për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit subvencione ju ndahen personave, jo kompanive dhe jemi shkue me këtë Rregullore që ende është në fuqi, që mendoj se shumë mirë ka funksionue deri tash. Mirëpo, tash e kemi

zgjerrje mundësinë e përfitimit të këtyre subvencioneve, nga familjet me asistencë sociale si kategori.

Shaip Paloja – Te neni 10, këta kanë bonus një pikë, por unë propozova që fare mos të ketë kufizime të nxënësit me aftësi të kufizuar dhe nxënësit e dëshmorëve. Mendoj se i vetmi kriter që duhet të jetë është të jenë të rregulltë në shkollë dhe të përcaktohet një numër i mungesave që nuk guxon të tejkalohet. Edhe për ndarjen e bursave për raste sociale, aty thuhet të jetë rezultati i mirë dhe të jenë nxënës të rregulltë, por nxënës i rregulltë mund të jetë edhe me 120 mungesa sepse shkolla është obligative me ligj. Mendoj se si kriter duhet të jetë që ata patjetër vetëm duhet të jenë të rregulltë në shkollë dhe mos të kenë mungesa. Tani, pyes një nxënës me 120 mungesa, a mund të llogaritet si nxënës i rregulltë.

Agim Spahiu – Përgjegjet se është nxënës i rregulltë, por nuk e ka vijue mësimin rregullisht. Nëse, nuk e specifikojmë që një bonus për një pikë, për studentë është fjala për persona me aftësi të kufizuar dhe fëmijë të dëshmorëve, pastaj këta në cilën kategori me i radhitë. Këta, e përfitojnë bursën, por është dyfishi i bonusit i kategorive tjera.

Burim Gërguri – Risi në këtë Rregullore është kategorizimi i bursave, do të marrin bursë të gjithë, por nxënësit që janë me 10 që e kanë mesataren më të lartë e kanë bursën më të madhe, ndërsa kategoria e 4, 3 me notën më të vogël. Këtu është një përparësi që drejtori është dashur me shpjegu në fillim. Këto raste, marrin bursë, por kategorizimi i tyre bëhet nga shkalla e parë në shkallën e dytë dhe rritet lartësia e bursës. Tash, e hudhi në votim Draft Rregulloren me ndryshimet dhe plotësimet në nenin 5 dhe 10.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” 2 vota “Kundër” dhe 2 vota “Abstenim” morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet Rregullorja për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Pika e 6 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqiti raportin përfundimtar të Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me nr.V-188, të dt.22.02.2019.

Arben Berisha – Unë si Kryetar i Komisionit vlerësues, në takimet e rregullta që i kemi pasë kemi bërë shpalljen në bazë të ligjeve në fuqi. Komisioni vlerësues ka rekomanduar që dhënien për shfrytëzim për 99 vite, të shpallen këto 2 kompani që kanë konkurue dhe çdo gjë është me dokumente të rregullta, ku si shtojcë ia kemi bashkangjitur dokumentacionin e kompletuar. Në fund ne rekomandojmë të aprovohet vendimi për këto kompani që kanë fitue.

Aziz Bici – Unë kam pyetje për drejtorin dhe për ju Kryetar, pse s’kemi informata për personat tjerë konkurues që janë refuzue, apo ishin vetëm këta 2 ofertues.

Arben Berisha – Përgjegjet se nuk kemi ofertues tjerë, por vetëm këta 2 kanë qenë, të cilët i kanë plotësuar të gjitha dokumentet e kërkuara nga Komisioni dhe kemi bërë shpalljen si përfitues të këtyre parcelave.

Aziz Bici – Tash, është pyetja më shumë për Kryetarin dhe për neve grupeve të partive, pse duhet të jepen pronat publike për 99 vite dhe a e dini se në këto zona mund të kemi më vonë projekte që janë shumë të vlefshme për Komunën tonë. Mendoj se prona publike në Komunën tonë duhet të jepet me kohë më të shkurtër sepse ne jemi qytet industrial dhe duhet të kemi parasysh që në të ardhmen pronat publike mund të shfrytëzohen me interes më të madh publik. Sipas Rregullores QRK, nr.23/2013, sipas nenit 3, duhet të formohet Komisioni i ankesave, i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim. Pyetja ime konsiston se a ka një Komision të tillë gjatë këtij procesi ku po jepen sipërfaqe dhe çka e bindi Komisionin që ti jepet Shegës, sipërfaqja e tokës prej 43,143 m² dhe “Burimi” SH.p.k 447 m² sidomos për Shegën është një sipërfaqe bukur e madhe mbi 4 ha, çfarë projekti ka ofrue. Ne mendojmë se kjo formë e dhënies së pronës publike nuk është në rregull dhe si rrjedhojë ne nuk e mbështesim këtë propozim të këtij Komisioni.

Kryetari – Ju e dini se edhe Komisionet vlerësuese janë mikse nga Kuvendi dhe Ekzekutivi, faktikisht është e drejtë ligjore deri në 99 vite, që e sqaroi edhe drejtori se janë komplet me dokumentacion. Ne si

Ekzekutiv, në këtë rast Kryetari nuk ka të drejtë implikimi në këtë çështje, por votohet në Kuvend dhe ju e keni krijuar mundësinë me u zhvillue si procedurë fillimisht. Pastaj, Komisioni e ka bërë shpalljen, trajtimin e tyre dhe është ky rezultat që na e kanë ofruar.

Burim Gërguri – Sqaron se janë 2 Komisione të formuara, Komisioni i vlerësimit dhe i ankesave, që i keni edhe në raport. Në të kaluarën, ne e kemi pasë një ankesë, që është trajtuar me materialin për 5 prona që janë dhënë. Tash, pse po e japim pronën për 99 vjet, sepse vendimi i parë i Kuvendit ka qenë se po e japim pronën në shfrytëzim për 99 vite, ndërsa ky është vendimi përfundimtar pas procedurave, pas thirrjes publike dhe pas vlerësimit të ofertave.

Aziz Bici – Fjala është për çështje procedurale, do të thotë ne nuk e kemi mendimin e Komisionit të ankesave.

Burim Gërguri – Komisioni është funksional, por nuk është ankuar askush dhe s'kemi çka me shqyrtue.

Arben Berisha – Sqaron se ankesa nuk ka pasë, për atë dhe nuk i kemi sjellë dhe kjo le të mbetet për shkak të procedurave. Ne kemi mendue për 99 vite, për shkak të projekteve serioze që janë sepse për projekte serioze në afat të shkurtër nuk aplikon asnjë njeri.

Aziz Bici – Neve, nuk na është dorëzuar asnjë projekt serioz për Shegën, se çfarë projekte serioze ka dhe në rast se na janë dorëzuar ju lutem tregoni se ku janë dorëzuar ato materiale.

Burim Gërguri – Komisioni e ka krejtë projektin prej shpalljes publike dhe të ftoj me ardhë në zyre te Komisioni me ta dhënë përgjegjen për çdo pikë. Dosjen e keni komplet dhe ju keni të drejtë si Kuvend me i rishiku vendimet se operatorët ekonomik a po i zbatojnë apo jo.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” 2 vota “Kundër” morën këtë:

V E N D I M

Miratohet dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit N.H.”Shega”.

Burim Gërguri – Tash, po e hudhi në votim dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit “Burimi” Sh.p.k.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” 2 vota “Kundër” morën këtë:

V E N D I M

Miratohet dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit "Burimi" SH.p.k.

Burim Gërguri - Paraqiti raportin përfundimtar të Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me nr.V-187, të dt.22.02.2019. Vendim përfundimtar nuk duhet të marrim sepse është fjala për dhënien e tokës në shfrytëzim afatshkurtër dhe për ju është vetëm informim për këtë çështje.

Shaip Paloja – Kërkon nga Komisioni të japë një arsyetim se çka nuk është plotësue.

Naim Miftari – Përgjegjet se nuk është plotësuar kriteri kryesor bazë për pagesën e tarifës prej 2 €, për m² ashtu qysh e parashehë Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale. Prandaj, për këtë arsye edhe është refuzue oferta e ofertuesit “Shtëpia e shpresës” për Shtëpinë e kulturës në Milloshevë.

Pika e 7 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e DSHPE-së, për lejimin e vendosjes së një trafoje nga ana e KEDS-it, në Plemetin për nevojat e banorëve të këtij fshati.

Naim Miftari – Këtu, fjala është për vendosjen e trafos shtyllë, për nevojat e banorëve të Plemetit dhe kishte me qenë mirë lejimi i saj sepse është edhe kërkesa e banorëve të cilët ankohen për tension të ulët të energjisë elektrike.

Shaip Paloja – Duhet të kemi parasysh se KEDS-i, është kompani private dhe në bazë të njoftimit të drejtorit aty parashihet të vendoset një shtyllë për trafo, e jo trafo. Mendoj se 2 metra me 2 është tepër për një shtyllë sepse mjafton 1 metër me 1 metër sepse shtylla vendoset, ndërsa trafoja vendoset në lartësi.

Enver Gashi – Sqaron se aq është 1 metër me 1 metër, por aty duhet të punohet rreth asaj dhe për atë është 2 metra me 2.

Aziz Bici – Duhet ta kemi parasysh se është fshat multietnik dhe këtu, dua të di se çka ka dashur me këtë të thotë drejtori dhe në rast se e keni marrë pëlqimin e komunitetit dhe nuk ka ndonjë ankesë për vendndodhjen. Në rast se ka pasë ndojë ankesë dhe është shqyrtue, janë respektue procedurat ne gjithsesi do ta mbështesim.

Naim Miftari – Përgjegjet se këtu, është e vërtetë se jetojnë komunitetet dhe ka qenë kërkesë e vazhdueshme e këtyre komuniteteve për tension të ulët të energjisë elektrike, të cilët pohojnë se gjatë ditës nuk mund të vënë në funksion asnjë pajisje të energjisë elektrike, që shpenzojnë më shumë se drita. Pra, kërkesa e tyre është e arsyeshme dhe nuk paraqet problem.

Aziz Bici – Kjo nuk është përgjegje sepse unë e kam kuptuar ndryshe dhe në rast se është diçka tjetër, atëherë është në rregullë. Unë jam kundër këtyre termeve që është fshat multietnik sepse edhe në fshatin multietnik ka ligje dhe ka rend. Në rast se ka pasë së paku një ankesë a është shqyrtue, ose s'ka pasë ankesa, është marrë mendimi i komunitetit, gjithsesi duhet të mbështetet.

Naim Miftari – Sqaron se pas debateve të fundit që i kishim me Kryetarin e Komunës, ka qenë edhe kërkesa e këtyre banorëve për vendosjen e trafos. Pra, destinimi kësaj hapësire është për vendosjen e trafos, e jo për ndonjë qëllim tjetër.

Aziz Bici – Pyeti se a ka pasë ankesa.

Burim Gërguri – Përgjegjet jo.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë për vendosjen e trafos në pronën shoqërore komunale me nr.të parcels P-72602052-00813-1, ZK Plemetin.

Pika e 8 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga MAPL, për rishikim të vendimit nr.I-203, të dt.31.12.2018, për lirim nga pagesa e taksave administrative për përfituesit e skemës sociale.

Arben Berisha – Ju informoj se Ministria e Planifikimit Hapësinor, ka nxjerrë tash një ligj që lirohen nga pagesa këta përfitues të ndihmës sociale, kështu që ju duhet ta shfuqizoni atë vendim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht morën këtë:

V E N D I M

Shfuqizohet vendimi nr.I-203, i dt.31.12.2018, për lirimin nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore, për të gjithë përfituesit e skemës të ndihmës sociale (të cilët paraqesin kartelën e ndihmës sociale të vlefshme) dhe për donatorë.

Pika e 9 e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Besnik Kastrati për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Aziz Bici – Propozoj që Drejtoritë përkatëse të punojnë rreth planit zhvillimor që sa më shpejt të përfundoj plani zhvillimor hapësinor, në mënyrë që të dihet se ku do të mbetet toka bujqësore dhe ku do të bëhet toka ndërtimore sepse ne sinqerisht po ju them se jemi duke marrë përgjegjësi shumë të mëdha. Ju e keni parë vetë tokën që e kemi nën sistemin e ujitjes se çfarë ndërtimi është duke u bërë me një hov shumë të madh atje. Unë sa e pashë që jam përgatitë me diskutue rreth pronës nuk e ka rekomandue KPF-ja, kërkesën e Rrustem Rukollit. Unë jam i gatshëm të japi kontributin tim sepse është shumë e rëndësishme që ne planin rregullativ ta përfundojmë sa më parë. Ju duhet ta dini se çfarëdo vote që japim, ndoshta ka nevojë për me dhënë, kemi me gabu që s'kemi me votue, por mos harroni sepse edhe ata që votojnë janë duke bërë gabime të mëdha sepse është duke u zënë toka bujqësore sidomos toka nën sistemin e ujitjes.

Arben Berisha – Ju informoj se e kemi tenderue planin zhvillimor dhe jemi duke punuar vazhdimisht sepse është shqetësimi ynë që nga fillimi, e kemi tenderue 3 herë dhe na ka dështue për shkakse s'ka pasë aplikacione të bollshme. Ne jemi mirë me procedura, por shqetësimi ynë është të shohim tash se si po përfundon përmes Prokurimit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 9 vota “Për” 1 votë “Kundër” dhe 2 vota “Abstenim” morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa e Besnik Kastratit, nga fshati Breznicë për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, parcel nr.00811-0, lloji i shfrytëzimit arë, klasës së 5-të, në sipërfaqe prej 8012 m² Zoka Kadastrale Milloshevë.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Shoqata sindikale e administratës komunale për ndihmë financiare për të realizuar një ekskurzion.

Kryetari – Ne e kemi diksutue në mbledhjen e Këshillit të drejtorëve dhe e kemi trajtue si kërkesë, janë planifikue 3,000 €, që kemi mundësi me ua dhënë. Mirëpo, të gjitha mjetet financiare duhet të arsyetohen me faktura pas kthimit për me mbulue shpenzimin.

Aziz Bici – Kërkesën e shoqatës sindikale për ekskurzion, ne nuk do ta përkrahim sepse interesi ynë komunal është që t’ju krijojmë atyre kushte më të mira të punës, por jo ekskurziona të tilla.

Fatmir Bekteshi – Ne si grup i LDK-së, e përkrahim këtë kërkesë dhe nëse, ka mundësi të rritet vlera e mjeteve edhe pak në 3,500 €, sepse e meritojnë meqë ju ka shtue puna me këtë buxhet.

Labinot Mirena – Unë mendoj se duhet të jenë 4,000 €, sepse ia vlen me i dërgue zyrtarët komunal në një ekskurzion pasi që po kanë ngarkesë të madhe dhe mjaft punë.

Kryetari – Sinqerisht ne e kemi diskutue këtë qështje me kryesinë e sindikatës dhe ju kemi tregue se kjo është mundësia që ne mundemi me ofrue. Shpresoj se edhe ata e kanë një pjesë në fondin e vet, por e rëndësishme që të kemi mbulesë me faktura të rregullta për shkak të auditimit, që mos të kemi probleme.

Fatmir Bekteshi – Propozoj të votojmë për vlerën e mjeteve prej 3,000 €, por të shkojmë edhe me një subvencion të vogël, një participim të vogël dhe ndoshta arrihet vlera e kërkuar.

Aziz Bici – Unë kisha pritë që vërtetë këtu, të diskutohet se cili është interesi i institucionit, e mos të thuhet se çka po punohet dhe nuk besoj se këtu është vendi për pazare. Unë po e quaj për pazare dhe e di se nuk është shprehje e lehtë sepse sikur të kishim informacione se ku kanë me shkue, çka kanë me vizitue, cilat janë përfitimet sepse në këtë gjendje bukur të rëndë sociale, ne po e shohim se çka është duke u bërë me qytetarët tonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota “Për” dhe me 2 vota “Kundër” morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa nga Shoqata Sindikale e Administratës Komunale, Obiliq që të ndahen mjetet në vlerën prej 3,000.00 €.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga Qendra rinore, për realizim të projektit “Avokim tek institucionet publike e private për të rekrutuar të rinjtë për punë vullnetare”.

Kryetari – Ne e kemi trajtuar si kërkesë dhe jemi të mendimit që me vazhdue prapë për 12 muaj për aktivitetin dhe punët vullnetare të potencuara në projektin e tyre. Mirëpo, te pagesa duhet të jenë të barabartë të gjithë dhe kordinatori në këtë rast të jetë njëjtë si të tjerët. Ata kanë treguar sukses me aktivitete të ndryshme, por prapë ju vendosni se a duhet me ua vazhdue edhe këtë vit, apo jo.

Xhezide Dragusha – Mendoj se duhet me vazhdue, por kordinatorja te pagesa duhet të veçohet nga të tjerët sepse ka përgjegjësi më shumë dhe s’duhet ta ketë pagën e njëjtë me të tjerët.

Aziz Bici – Ne do ta përkrahim kërkesën e tyre, por kërkojmë që të monitorohet dhe raportohet që të dijmë më shumë rreth përmbajtjes së projektit, me qëllim të promovimit të vullnetarizmit në mënyrë që të ndihmojmë edhe më tutje në forma të ndryshme.

Kryetari – Ne kemi menduar meqë, është punë vullnetare se edhe kordinatorja duhet të jetë në nivel të barabartë me të tjerët, edhe për shkak të buxhetit.

Labinot Mirena – Pyeti se kush janë ata 5 vullnetarë.

Burim Gërguri – Përgjegjet se ata i cakton Qendra Rinore dhe emrat e tyre nuk i kam, por ata kanë një marrëveshje në vazhdimësi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa nga Qendra Rinore në Obiliq për mbështetjen për vitin 2019, për Projekt Propozimin “Avokim tek institucionet publike e private për të rekrutuar të rinjët për punë vullnetare” i cili project është financuar nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerën prej 9,000.00 €.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e OVL-UÇK, që mjetet e ndara nga Kuvendi komunal për vitin 2019, të bëhen në llogari të qendrës së OVL-së, të UÇK-së.

Kryetari – Ne e kemi trajtue këtë kërkesë dhe pajtohemi që me mbështetë OVL-në, por në kërkesë mungon llogaria dhe për këtë ne mund t’ua bëjmë një shkresë, ose edhe ju mund t’ua bëni sepse juve iu ka drejtuar kërkesa. Po ashtu, edhe ne kërkojmë që mjetet e shpenzuara të dëshmohen me fakturë, ose vulë të veteranëve se janë shpenzue. Në momentin që na e sjellin xhirollogarinë, ne do ta bëjmë barjen e mjeteve.

Labinot Mirena – Pyeti se në të kaluarën a janë ndarë mjete, sa ka qenë vlera e tyre dhe a i kanë sjellë fakturat se ku i kanë shpenzue ato mjete. Nëse, nuk e kanë sjellë në fund të vitit të kaluar se ku i kanë shpenzue mjetet, unë jam për mos me votue.

Kryetari – Sqaron se vendimi i Kuvendit komunal ekziston dhe kërkesa faktikisht është dashur të dorëzohet te Ekzekutivi, por ata e kanë sjellë në Kuvend, që nuk ka asnjë të keqe absolutisht. Problemi i ekzekutimit është vetëm xhirollogaria, ndërsa ju e dini se auditori kërkon mbulesë për shpenzim të mjeteve dhe ne në mënyrë proporcionale, në fund të vitit do të kërkojmë të gjitha sqarimet.

Aziz Bici – Pyeti se a ka pasë më heret xhirollogari, po kërkohet vetëm tash, apo ka ndërruar diçka. Po ashtu, pyes se kërkesa a është bërë për vitin 2019, apo për vitin paraprak. Edhe unë jam për atë se nëse, nuk arsyetohen mjetet ku janë shkue, duhet me pasë kujdes me ditë çka është bërë.

Kryetari – Përgjegjet se me siguri se ka pasë më heret xhirollogari sepse mjetet ju janë dhënë, por sigurisht se kanë harrue me dhënë xhirollogarinë. Besoj se është gabim teknik në kërkesë dhe shpresoj që ata të na sjellin xhirollogarinë, që mjetet t’ju alokohen.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e Labinot Rrukollit dhe Rrustem Rukollit për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, ZK Milloshevë.

Mbetet, që për këtë kërkesë Drejtoria përkatëse të na jepë sqarim, pastaj të trajtohet në muajin prill.

Pika e 10 e rendit të ditës

Aziz Bici – Sipas informacioneve që kemi, kohëve të fundit në fshatin Plemetin, kanë fillue të ndërtohen disa shtëpi për komunitetin rom, të cilët po vijnë nga vendet për ne të panjohura. Pyetja është kush janë këta qytetarë, nga cilat vende po vijnë, kush është donatori i këtyre shtëpive që po ndërtohen dhe e kujt është prona në të cilën këto shtëpi po ndërtohen.

Hysni Mjeku – Dua ta bëjë një pyetje, meqenëse shumica e rrugëve që janë paraparë janë shtruar me zhavorr, kur do të fillon asfaltimi i tyre.

Arbnore Nasufi – Ne si grup i grave, në takimin e fundit që kemi pasur, e kemi parë të arsyeshme me kërkuar një zyre për zyrtaren për barazi gjinore. Kjo zyre është e domosdoshme sepse shumica e grave që vijnë me kërkesa të ndryshme, në takimet që i mbajnë nuk e kanë hapësirën adekuate për me pasë privatësi për problemet e tyre. Pra, kërkoj një zyre për zyrtaren për barazi gjinore dhe njëkohësisht edhe ne i mbajmë mbledhjet e takimeve tona aty, në mënyrë që të kemi hapësirën e duhur.

Fatmir Bekteshi – Unë e kam një kërkesë prej disa firmave transportuese publiko-private që ata ta kenë një lehtësim, ose një taksë vjetore që e paguajnë prej 200 €. Tash pasi që është në përfundim e sipër Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, që kjo taksë të hiqet. Arsyeja është se qytetet në rrethinë që i kemi psh Prishtina, Fushë Kosova, Lipjani, te ata kjo nuk ekziston, prandaj nëse, ka mundësi dëshiroj që të hiqet kjo taksë edhe në Komunën tonë.

Shaip Paloja – Para disa dite ka qenë një informatë se në Komunën e Obiliqit, do të ndërtohen disa panele solare për energji të ripërtrishme. Sipas informatave që i kam ato mund të vendosen për afërsisht te hiri i Kosovës A, dhe pyes sa ka zhvillime rreth kësaj çështjeje.

Aziz Bici – Te tabela shkruan 60 copë, ndërsa te dalja është 70, a është bërë ndonjë gabim apo çka është në pyetje.

Burim Gërguri - Përgjegjet se është gabim teknik, me siguri se duhet të jetë 70.

Xhezide Dragusha – Unë kam një kërkesë se në komunikim verbal me nxënës, studenta, me banorë në përgjithësi meqenëse, projekti tash ka përfundue te trotuari Raskovë, Milloshevë e këndej. Është një kërkesë e tyre rruga drejtë me Bakshi, që është shtrur dhe pjesa poshtë që aty, te stacioni me u vendosë një vend për stacion dmth pjesa afër trotuarit. Kërkesa e tyre është se po kanë problem me udhëtim, për shkak të autobusit mos me u ndalë në rrugë dhe me bë vetëm një kthesë për me ditë që është stacion.

Kryetari – Përgjegjet te pjesa e ndërtimit të shtëpive që pyeti z.Aziz, është marrëveshja me Bashkimin Evropian me Ministrinë e kthimit, që trajtimin e të kthyerve e bën kryesisht Zyra për komunitete. Ne rikthimin e kemi stopue dhe do të mundohemi me i stopue të gjithë ata që nuk janë të Komunës tonë sepse është vullnet i vetë qytetarëve të Plemetinit, për ata që nuk ju përkasin Komunës tonë, mos t’ju krijohet mundësia me ndërtue. Unë besoj se kështu, do të ndodhë sepse atje, ka fillue të mbi popullohet dhe ky veprim është ndalë që nga viti i kaluar. Sa i përket shtrimit të rrugëve, nëse nuk gaboju kompanitë e kanë planin dinamik 30 ditë, për me i përmbyllë projektet e asfaltimit dhe shpresoj se në këtë afat kohor ato do ti përmbyllim. Çështjen e heqjes së taksës te kompanitë transportuese, ne do ta shqyrtojmë patjetër, por po presim sepse Ministria e financave, është duke i trajtuar të gjitha problematikat e taksave dhe për këtë arsye sot nuk e kemi sjellë Draft Rregulloren, jemi në pritje dhe shpresoj se do ta diskutojmë. Sa i përket vendosjes së solarëve, e di se grupi punues është duke punuar, është edhe një përfaqësues i Komunës tone. Ata kanë kërkuar pjesë shtesë të sqarimit të hapësirës sepse ajo është hapësira e KEK-ut, dhe vetë KEK-u pretendon me bë, ndërsa dikush pretendon tjetër në mënyra private. Mirëpo, sidoqoftë çdo informatë që ne e marrim këtu, do ta sjellim. Sa i përket pyetjes së znj.Xhezide, ne do ta shohim nëse, është pronë private është mënyra e shpronësimit, apo nëse na e liron në mënyrë vullnetare ma merrë mendja që si problem do të trajtohet. Ndërsa, për zyre ne e kemi diskutue edhe me OSBE-në, me znj Ganimete Aliu dhe problemi është se ne e kemi sistemin e hapur. Ne i kemi thënë znj.Ganimete dhe i themi prapë se sa herë që i vyen një zyre për trajtim të një problemi të veçantë që nuk duhet ta dijë askush, ne e kemi një zyre të takimeve dhe përherë mund t’ja liroj pa asnjë problem. Nëse, ajo zyre është e zënë mund t’ja liroj edhe zyren time, apo cilëndo zyre që ka nevojë. Mirëpo, mundësia me kriju zyre pa e bë një projekt të ri të ndarjeve brenda Komunës, nuk ka mundësi. Ne kemi edhe sektore tjera që kanë kërkesa të tilla si ZKKK-ja, por në mungesë të hapësirave është kjo mundësia që ne mund të ofrojmë.

Arbonore Nasufi – Faleminderit Kryetar, ne e dijmë se kemi në dispozicion sallën tuaj aty, ku ju thoni por kishte qenë ndoshta, më mirë me pasë një zyre për shkak se shumica e grave që vijnë me ankesa të ndryshme psh edhe ne nganjëherë po e ngritim pak zërin kur po flasim më shumë se që duhet dhe kjo po bëhet pengesë.

Kryetari – Përgjegjet znj.Ganimete Aliu, mund të na tregoj nëse, ne e kemi ndonjë zyre të pashfrytëzueshme dhe ne mund ta shqyrtojmë, por seriozisht është sistemi i hapur.

Mbledhja përfundoi në ora 12:50’

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri